



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

Njoftim

“Për kriteret që duhet të plotësojë një anëtar i Senatit Akademik”

Kandidati për anëtar të Senatit Akademik duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Nenin 18 dhe në Nenin 22 pika 1 të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike” si dhe duhet të paraqesë pranë sekretares së KIZ, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën për kandidim, e cila përmban:

- emrin;
- atësinë;
- mbiemrin;
- datëlindjen;
- gjininë;

b) kopje të dokumentit të identifikimit;

c) kopje të noterizuar të titullit akademik;

d) dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar, vendin dhe vitet e punësimit.

e) shprehjen e vullnetit për kandidim;

f) formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ) për:

- deklarin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion;
- mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik, sipas aneksit 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje;
- deklarin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
- deklarin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- deklarin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.

g) të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor, jo më pak se 10 (dhjetë) vjet

h) të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë

zhvilluar kurrikula, programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe ose të kenë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 5 (pesë) vjetësh.

Kryetari

Hasan Bello

